

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës nr.1 të KSHZ “Për vendosje sanksioni administrativ, sipas vendimit nr. 467, datë 11.11.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.L.Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y.Merkaj, Z. E.Mema.
- **Të tjerë:** Z. Florian Pullazi, administrator i Njesisë
Administrative nr.2, Tiranë.
Z. Erjon Cuku, jurist i Njesisë
Administrative nr.2, Tiranë.

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, hapim seancën për shqyrtimin e propozimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vendosje sanksioni administrativ. Siç e dini kjo është seancë e cila u vendos pas vendimit të ndërmjetëm të këtij komisioni për të kthyer për plotësim aktet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pasi nuk ishin në formën e kërkuar nga ligji, nga Kodi Zgjedhor dhe nga rregulloria e funksionimit të KAS-it. Kjo seancë do të drejtohet nga unë Elvis Çefa, në cilësinë e relatorit. Verifikojmë prezencën. Prezent administrata e KQZ-së e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Është prezent personi i interesuar, nuk e di nëse ka paraqitur kërkesë, ju lutem prezantohuni!

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021**

Z. F. Pullazi: Përshëndetje, quhem Florian Pullazi, administrator i Njesisë nr. 2, Tiranë.

Z. E. Çefa: Faleminderit, ju vini besoj në cilësinë e personit të interesuar. Do të përfaqësoheni vetë, apo me dikë tjetër?

Z. F. Pullazi: Kam zgjedhur të përfaqësohem vetë.

Z. E. Çefa: Dakord! Përpara se të fillojmë ndonjë kërkesë nga anëtarët e KAS-it për deklaram të konfliktit të interesit? S'ka! Kërkesë tjetër paraprake nga palët?

Z. F. Pullazi: Jo!

Z. E. Çefa: Para se t'i jap fjalën Sekretarit të Përgjithshëm, dëshiroj të sqaroj sikurse e thashë edhe në fillim. Në plotësim të vendimit të marrë në datën 14 dhjetor nga ky komision, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka plotësuar anën formale të kërkesës dhe ka paraqitur në datën 17.12.2021 kërkesën drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për vendosjen e sanksionit administrativ gjobë, në shumën pesë mijë lekë të reja ndaj zotit Florian Pullazi, administrator i Njesisë Administrative nr.2. Në këtë kontekst, kërkesa konsiderohet e plotë dhe mund të fillojmë trajtimin në themel të saj. Jua jap fjalën zoti Sekretar i Përgjithshëm për të na parashtruar shkurtimisht faktet dhe rrethanat e çështjes.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve, në datën 19.03.2021, është raportuar nga Organizata "Qëndresa Qytetare" denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2368, ndaj kandidatëve për deputetë të subjektit

Zbardhi materialin audio


Merita DULAKU



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021**

Partia Socialiste e Shqipërisë, zotit Alqi Bllako dhe Bashkisë Tiranë për kryerjen e një aktiviteti elektoral në ambjentet e Bibliotekës “Moikom Zeqo”. Në bazë të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, dhe 91, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, neneve 60, 61 dhe vijues të “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri vendosi të fillojë procedurën administrative me palë: denoncuesin, Organizatën “Qëndresa Qytetare”, kundër: subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Bashkisë Tiranë, kandidatit për deputet, zotit Alqi Bllako dhe administratorit të Bibliotekës “Moikom Zeqo”. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se, në Bibliotekën “Moikom Zeqo” është zhvilluar një aktivitet me natyrë zgjedhore me votuesit për herë të parë të Njesisë Administrative nr. 2, në Tiranë, me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkisë Tiranë, zotit Erion Veliq si dhe kandidatit për deputet zotit Alqi Bllako, të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Nga provat e vëna në dispozicion, konstatohet se pjesëmarrësit kanë zhvilluar fushatë elektorale. Administratori i Njesisë Administrative nr.2, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve, ka lejuar zhvillimin e një veprimtarie me qëllim zgjedhor në mbështetje të kandidatit për deputet në mjediset e Bibliotekës “Moikom Zeqo”, e cila përbën aset të paluajjtshëm, burim të organit publik, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Gjatë hetimit administrativ u thirr dhe u dëgjua për të parashtruar pretendimet e tij administratori i njesisë administrative nr. 2, Tiranë, i cili mohoi faktin e zhvillimit të veprimtarisë me qëllime zgjedhore në Bibliotekën “Moikom Zeqo”. Identifikimi i administratorit si palë në proces e në përfundim të hetimit, cilësimi i tij si person përgjegjës për zhvillimin e aktivitetit elektoral në mjediset e bibliotekës, i referohet parashikimeve të nenit 33.2, pika 6, të vendimit nr. 25661, datë 02.07.2018, të Kryetarit të Bashkisë

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Dt.21.12.2021

Tiranë, “Për një ndryshim të rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”, “Administratori i Njesisë Administrative siguron një miradministrim të këndeve të lojërave, terreneve sportive, bibliotekave, shtëpive dhe klubet e rinisë”. Nga të dhënat që disponohen nuk rezulton që zoti Pullazi të jetë përsëritës. Në kuptim të nenit 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor, subjektet zgjedhore ndëshkohen administrativisht në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, me parakushtin që subjektet zgjedhore, të kenë marrë dijeni dhe pas marrjes dijeni të mos kenë marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Në rastin objekt shqyrtimi, nuk u provua që subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, të jetë vënë në dijeni. Për sa më sipër, përgjegjësia administrative është në ngarkim të personave që kanë për detyrë miradministrimin e këtij asemi në përputhje me parashikimet e ligjit dhe akteve nënligjore duke u përjashtuar nga përgjegjësia penale partia politike apo kandidati për deputet që mund të ketë kryer këtë aktivitet. Në cilësinë e provës, ju paraqesim ato që vetë denoncuesi, Organizata “Qëndresa Qytetare”, ka vendosur në dispozicion dhe konkretisht tre link-e të rrjetit social “Facebook”, në të cilin sipas saj, gjenden provat e këtij aktiviteti. Bazuar në nenin 19, shkronja “c”, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 35, në vendimin nr.03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kërkon të vërë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve për zbatimin e pikës 1, të nenit 171, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, për vendosjen e sanksionit administrative ndaj zotit Florian Pullazi, Administrator i Njesisë Administrative nr.2, Tiranë, në vlerën pesë mijë lekë, faleminderit!

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021*

Z. E. Çefa: Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm. Atëherë, zoti Pullazi në qoftë se keni diçka për të thënë, tani është momenti.

Z. F. Pullazi: Faleminderit zoti drejtues i seancës! Duke qenë i pranishëm në çdo seancë që jam thirrur, ka qenë një shprehje respekti ndaj institucionit. Dua të theksoj dy gjëra që në fillim, për sa i përket seancës së parë që unë jam thirrur dhe erdha u paraqita këtu në institucion. Atë ditë jam vënë para fakteve dhe nuk është ajo që..., me gjithë respektin për sekretarin, që thotë pranoi. Unë jam shprehur në multifunksionalitetin e bibliotekave në të gjithë Tiranën dhe jo vetëm të njësisë time. Ne jemi miradministrim, mirëmbajtje dhe gjëra të tilla. Unë nuk kam pranuar, ajo që kam shprehur para Komisionerit..., unë u vura para dijenisë së faktit. Ishin bërë disa dëgjesa me shoqatën dhe persona të tjerë. Ditën që u vendosa para faktit e mora të mirëqenë dënimin me gjobë. Gjithësesi, unë do të dëgjoj dhe vendimet e komisionit dhe pastaj do të shprehem me kërkesën time drejtuar KAS-it, faleminderit!

Z. E. Çefa: Dakord, ju faleminderit! Besoj se do të ketë vend për pyetje nga kolegët?!

Z. E. Lako: Thjesht për të sqaruar. Kjo është seanca ku do të shqyrtohet vendimmarrja. Ka ndryshuar forma, nuk u pranua nga KAS-i në atë formë që erdhi, nga Komisioneri është riparë dhe ka ndryshuar forma. Pra, jeni vënë në dijeni ju për këtë?

Z. F. Pullazi: Nuk jam vënë në dijeni, sot mora materialin në seancë. Por gjithësesi...

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021*

Z. E. Çefa: Zoti Pullazi, a jeni dakord që ne ta vazhdojmë trajtimin e propozimit të Komisionerit për gjobitjen tuaj, në këtë seancë.

Z. F. Pullazi: Po, po po!

Z. E. Çefa: Atëherë po vazhdojmë! Në mbrojtjen tuaj, a keni për të shtuar diçka tjetër më konkrete, apo të kalojmë në fazën e pyetjeve në qoftë se ne kemi?

Z. F. Pullazi: Mendoj të kaloni në fazën e pyetjeve.

Z. E. Çefa: Unë kam një pyetje, në qoftë se kolegët nuk kanë. Ju thatë që keni vetëm tagrat e miradministrimit të bibliotekës. Nuk di a mund të ma specifikoni. A jeni ju ligjërisht personi përgjegjës për administrimin e mënyrës së përdorimit të bibliotekës në të cilën bëhet fjalë të jetë ushtruar veprimtaria konkrete, apo ka ndonjë person tjetër? E thënë shkurt! Nëse dikush kërkon të bëjë një aktivitet në bibliotekë, ju jeni personi i cili jep autorizimin, jep lejen apo jo?! Ju lutem, nëse po, ose jo, referoni nëq është e mundur dispozitën ligjore, ose rregulloren e bashkisë që e përcakton këtë.

Z. F. Pullazi: Faleminderit i nderuar, unë do t'i referohem ligjit për vetëqeverisjen vendore dhe vendimit të këshillit bashkiak. Janë dy pika që unë doja të sqaroja dhe KAS-in. Ligji për vetëqeverisjen vendore ka të përcaktuar tagrin që më jep Bashkia Tiranë për të administruar pronat e Bashkisë Tiranë, një kjo! Ndërsa vendimi i këshillit bashkiak thotë "Detyrat e administratorit: siguron mbështetje, siguron një miradministrim". Nëq do t'i referohemi dhe kërkesave që bëhen në Bashkinë Tiranë, është lehtësisht e verifikueshme dhe rasti. Bashkia Tiranë ka një aplikim on-line ku bëhet aplikim nga çdo person juridik, fizik një kërkesë për të marrë në përdorim një

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021*

ambjent për të bërë një aktivitet brenda tyre, rasti konkret biblioteka. Pra, ka një mundësi tek aplikimi on-line i Bashkisë Tiranë për të marrë në përdorim një nga bibliotekat e Tiranës. Në këtë aspekt, unë si administrator e kam në administrim bibliotekën, por jo direkt, sepse biblioteka varet dhe nga Drejtoria e Promovimit të Qytetit. Pra, ka një varësi të dyfishtë.

Z. E. Çefa: Po zoti Braho!

Z. L. Braho: Unë dua të di.., bie dakord që ka një procedurë në faqen on-line të Bashkisë Tiranë. Jeni ju personi përgjegjës që e miratoni këtë kërkesën e kujt do qoftë?

Z. F. Pullazi: Kërkesa shkon në Bashkinë Tiranë, e miraton Drejtoria e Promovimit të Qytetit.

Z. K. Bele: Kush e hap bibliotekën? Unë jam kryetari i shoqatës së veteranëve dhe do të bëj një aktivitet.

Z. F. Pullazi: Biblioteka ka tre punonjës me turne që janë punonjës të Bashkisë Tiranë.

Z. K. Bele: Ju komunikoni punonjësit që shoqata në fjalë do të vijë në orën “x”?

Z. F. Pullazi: Përfaqësues nga drejtoria që merret me këtë proces.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.21.12.2021

Z. K. Bele: Pra, nëse e kuptova drejt, është një drejtori e bashkisë që bën kontrollin për natyrën e aktivitetit të kërkuar dhe autorizon kryerjen ose jo të këtij aktiviteti?

Z. F. Pullazi: Po!

Z. K. Bele: Pra, nqs është një organizatë..,

Z. F. Pullazi: Po, ka pas dhe një marrëveshje të firmosur nga drejtoritë e bashkisë për të vënë në dispozicion bibliotekat për një organizatë që do të kryente aktivitete të caktuara. Pra, nuk është e lidhur me mua si administrator. Unë e saktësova se dhe në vendimin e parë, unë quhesha administrator i bibliotekës. Unë jam administrator i njësisë administrative, nuk jam administrator i bibliotekës. Pra, duke ju referuar vendimit të parë dhe emërtimit që më ishte bërë.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Po, zoti Rusmali!

Z. I. Rusmali: Ata punonjësit që administrojnë bibliotekën, janë staf i njësisë administrative, apo staf i bashkisë?

Z. F. Pullazi: Ne të gjithë jemi staf i bashkisë, duke parë dhe funksionet qoftë nga ndryshimi i ligjit për vetëqeverisjen vendore, ndryshimin e kompetencave të njësisë bashkiake me njësinë administrative. Ato borderotë i kemi të gjitha në njësinë nr.2. organigrama plotësohet për njësinë nr.2.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.21.12.2021

Z. I. Rusmali: Ky vendim është marrë para më shumë se një muaj nga Komisioneri, ju keni pas të drejtën e ankimit ndaj tij. Pse nuk e keni shfrytëzuar të drejtën e ankimit ndaj atij vendimi?

Z. F. Pullazi: Nuk e kam shfrytëzuar të them të drejtën, sepse nuk ka pas objekt për çfarë të ankohesha. Pra, unë jam munduar të orientoj dhe vetë stafin e KQZ-së për mënyrën se ku do të adresohet. Kjo ka qenë arsyeja kryesore që unë nuk kam bërë ankimim, plus që për çfarë po dënohem?! Vendimi i ndryshuar i Komisionerit thotë që jeni dënuar me pesë mijë lekë gjobë.

Z. E. Çefa: Për sqarim, Komisioneri ka propozuar. Deri tani në këtë fazë nuk jeni as i dënuar, as i sanksionuar. Jemi diskutuar pikërisht këtë. Për këtë arsye ishin edhe pyetjet.

Z. F. Pullazi: Po, por herën e parë nuk kishte diçka konkrete.

Z. E. Çefa: Dakord ju kuptova. Unë kam një pyetje për administratën nqs është e mundur. A është administruar si provë vendimi nr.25661, dt.2.07.2018 i kryetarit të Bashkisë Tiranë, “Për një ndryshim të rregullores së organizimit dhe funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”?

Z. Y. Merkaç: Për të administruar nuk e kemi administruar, por e kemi pas përpara.

Z. E. Çefa: A e kemi një kopje?

Z. Y. Merkaç: Në këtë moment jo, por do të zbres poshtë dhe e sjell.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021*

Z. E. Çefa: Dakord! E keni ju?

Z. F. Pullazi: Po!

Z. E. Çefa: Mund të na e depozitoni një kopje, ju lutem!

Z. F. Pullazi: Po, patjetër!

Z. I. Rusmali: Bibliotekat mbulohen nga një drejtori në bashki. Si quhet drejtorja?

Z. F. Pullazi: Drejtorja e Promovimit të Qytetit. Bashkë me ne, nuk po e heq veten time..

Z. I. Rusmali: Kërkesa për përdorimin e bibliotekave miratohet nga Drejtorja e Promovimit të Qytetit. Drejtuesi i kësaj drejtorie në periudhën e zgjedhjeve kush ka qenë?


Z. F. Pullazi: Nuk di të them, duhet ta shoh që ta them saktë.

Z. I. Rusmali: Nuk jeni në gjendje ta thoni këtë.

Z. E. Çefa: Pyetje të tjera nuk ka nga kolegët? Po zoti Lako!

Z. E. Lako: Kam një pyetje, si për administratën, ashtu dhe për palën e interesuar. Ky aktiviteti që besoj se duhet të jetë hetuar dhe nga KQZ-ja që ka dalë në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021*

konkluzionin që është një aktivitet ku kanë marrë pjesë këta persona dhe që ka pas natyrë të karakterit politik gjatë fushatës. A është ndjekur ndonjë procedurë për marrje leje për zhvillimin e aktivitetit? Pra, a është ndjekur kjo që thatë ju, marrja e lejes? Apo është marrë e mirëqenë për shkak se në aktivitet ka qenë dhe kryetari i bashkisë?

Z. F. Pullazi: Unë nuk kam informacion se as vetë nuk kam qenë te ky aktivitet. Nuk di të them, unë nuk kam qenë dhe jam vënë në dijeni për këtë aktivitet kur kam ardhë këtu.

Z. L. Braho: Këta punonjësit e bibliotekës, përsa i përket marrëdhënieve të punës, të drejtave dhe detyrimeve që kanë në marrëdhëniet e punës, i kanë kundrejt jush si administrator i bashkisë, apo i kanë..,

Z. F. Pullazi: I kanë me bashkinë. Çdo kontratë pune firmoset nga kryetari i bashkisë, nga titullari i institucionit.

Z. E. Çefa: Dakord, besoj se e ezauruam këtë fazë të procesit.

Z. Y. Merkaj: Në portalin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, tek faqja zyrtare e KQZ-së ka qenë portali dhe si rregull duhet të ishte deklaruar kjo veprimtari pesë ditë para zhvillimit të saj. Nuk është deklaruar as nga bashkia, as nga njësia administrative.

Z. E. Lako: Dakord, meqenëse nuk është deklaruar është aktivitet i ndaluar, por tani po flas.., për rastin konkret po flasim për rastin e përgjegjësisë. Pra, a rezulton që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.21.12.2021

është ndjekur procedura për marrje leje për t'u zhvilluar aktiviteti, apo është marrë e mirëqenë për shkak se ka qenë vetë kryetari në atë aktivitet?

Z. Y. Merkaj: Rezulton që nuk është marrë leje.

Z. I. Rusmali: Jo në raport me KQZ-në. Juve ju ka dhënë informacion bashkia për procedurën bashkiake të zhvillimit të këtij aktiviteti. Ka pas aplikim në drejtorinë e bashkisë për të zhvilluar këtë aktivitet? Ky aplikim është miratuar nga drejtoria e bashkisë? Këtë gjë, këtë procedurë të brendshme e keni hetuar jo apo jo? Kjo është pyetja e kolegut.

Z. Y. Merkaj: Gjatë hetimit administrativ nuk ka dalë që të jetë marrë leje. Nuk është bërë as kërkesë për të marrë leje për zhvillimin e aktivitetit.

Z. L. Braho: Ajo që vlen për të qartësuar është të dijmë që ka pas një procedurë të ndjekur nga Drejtoria e Promovimit të Qytetit për këtë rast? Apo thjesht kanë qenë disa individë që kanë shkuar tek dera e bibliotekës, duke qenë dhe kryetari i bashkisë s'ka pas procedurë fare, sepse kjo do të na ndihmojë të kuptojmë se kush e ka shkelur ligjin, nëq ka shkelje të ligjit.

Z. Y. Merkaj: Pra, gjatë hetimit administrativ nuk ka pas procedurë. Nuk ka pas as kërkesë dhe as miratim, as aplikim për leje.

Z. K. Bele: Po ku e gjejmë këtë gjurmë të faktit që është pyetur bashkia shkresërisht, apo ndoshta...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.21.12.2021

Z. Y. Merkaj: Është tek vendimi nr. 467...

Z. K. Bele: E ka vendimi, dakord ndoshta unë nuk e kam vënë re.

Z. I. Rusmali: Komisioneri ka propozuar në kërkesën e tij vendosjen e sanksionit në masën pesë mijë lekë, mbështetur në paragrafin e parë të nenit 171. Keni ndonjë prapësim juridik për t'i bërë kësaj kërkesë, pra masës së gjobës dhe referencës ligjore? Apo nuk shihni argument juridik karshi tyre?

Z. F. Pullazi: T'i referohesha pak më parë kërkesës që është bërë, mua si institucion nuk më ka ardhur një kërkesë nga KQZ-ja për të marrë informacion ndaj këtij aktiviteti që kërkohet, e para. E dyta që doja të thoja, ne jemi institucion që merremi me menaxhimin e zgjedhjeve në zonë. Pra, pak a shumë jemi të informuar për të gjitha sanksionet që mund të derivojnë nga ligji. Duke qenë dhe institucion që jemi munduar të jemi sa më korrekt në zbatimin e ligjit, nuk besoj se kemi qenë palë e interesuar për të bërë këto shkelje. Unë di të them këtë që KQZ-ja duhet të ishte orientuar më mirë dhe nuk ka pse të vendosë vulën tek emri e mbiemri im për të vënë një sanksion gjobe, ndërkohë që në të gjitha marrëdhëniet ligjore kam qenë shumë korrekt në zbatimin e ligjit. Gjithësesi kjo është vendimmarrja e KQZ-së dhe nuk kam çfarë të them tjetër.

Z. I. Rusmali: Nqs mund të jemi më konkret, njësia administrative ka detyra konkrete në raport me zgjedhjet për sa i takon listës së zgjedhësve dhe qendrave të votimit. Konkretisht këto janë detyrat që ju mbuloni për zgjedhjet?

Z. F. Pullazi: Po, po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021*

Z. I. Rusmali: Në njësinë tuaj administrative nuk janë konstatuar gjatë zgjedhjeve problematika në raport me listat e zgjedhësve dhe qendrat e votimit. Këtë po thoni, apo jo?

Z. F. Pullazi: Në asnjë lloj momenti..., kam qenë administrator për dy palë zgjedhje dhe nuk kemi pas asnjë lloj problemi as nga KQZ-ja, por as nga subjekte të tjera në lidhje me administrimin e këtyre proceseve.

Z. E. Cuku: Sidomos për objektet private që kanë qenë..., duke qenë dhe territori pak i vështirë...

Z. I. Rusmali: Me mikrofon të lutem se janë të rëndësishme!

Z. E. Cuku: Njësia Administrative nr.2 duke qenë se ka një shtrirje shumë të gjatë, është një nga njësitë që ka në territorin e saj shumë objekte private. Ne jemi treguar shumë të kujdesshëm, se po dalim jashtë kësaj pjese, në zbatimin e udhëzimit të KQZ-së që është për gjetjen e objekteve pa përfshirë çështje politike. Në zgjedhjet që kishim tani kemi qenë shumë mirë.

Z. I. Rusmali: Nuk keni pas vendime që të ndryshonin objektet private për zgjedhjet?

Z. E. Cuku: Jo, jo! Të paktën, unë kam që nga 2014 që jam si koordinator nga bashkia për njësinë, për të menaxhuar gjetjen e objekteve publike dhe private, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021*

Z. E. Çefa: Thjesht për efekt procesverbali, zotëria që kishit fjalën, kush jeni ju lutem? Na u prezantoni!

Z. E. Cuku: Unë jam Erjon Cuku, jam juristi i Njësisë Administrative nr.2, Bashkia Tiranë.

Z. E. Çefa: Dakord, faleminderit! Po zoti Braho!

Z. L. Braho: Tek faqja e Bashkisë Tiranë, unë gjeta këtë pjesën ku flitet për bibliotekat e lagjeve si qendra multifunksionale. Aplikantët e pranueshëm, gjithmonë sipas faqes së bashkisë, janë vetëm organizatat jofitimprurëse. Edhe në formularin e aplikimit që i bashkëlidhet në këtë faqe, flet vetëm për OJF dhe në aplikim bashkëlidhet vendimi i gjykatës. Tani këtu nuk e di, zoti Sekretar i Përgjithshëm, kjo ka nisur nga një OJF, ky aktivitet? Keni informacion, kush ka qenë iniciatori i këtij aktiviteti?

Z. Y. Merkaç: Denoncimi është nga Qëndresa Qytetare...

Z. L. Braho: Jo denoncimi, aktiviteti i denoncuar?

Z. Y. Merkaç: Nuk ka...

Z. L. Braho: Nuk ka informacion për këtë pjesë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021*

Z. E. Çefa: Dakord, pyetje të tjera nuk ka besoj kështu që mund të kalojmë në fazën e konkluzioneve përfundimtare. Për Komisionerin besoj...

Z. Y. Merkaç: Po, i qëndrojmë kërkesës. Konstatimin e shkeljes dhe marrjen e masës së sanksionit me pesë mijë lekë.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Zoti Pullazi, përfundimisht, çfarë i kërkoni këtij Komisioni?

Z. F. Pullazi: Mendoj që i ezaurova të gjitha kërkesat e mia dhe s'kam çfarë shtoj më tepër. Përfundimisht kërkoi rrëzimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, se është e padrejtë.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Tani KAS do të tërhiqet për të diskutuar për çështjen dhe për 30 minuta do t'u thërrasim për të shpallur vendimin, faleminderit.

Rifillon seanca

Ora 14:14

Z. E. Çefa: KAS pasi e diskutoi çështjen në tërësi, vendosi:

Rrëzimin e kërkesës nr.1/1, datë 17.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vendosjen e sanksionit administrativ gjobë, në shumën pesë mijë lekë ndaj zotit Florian Pullazi.

KAS arriti në konkluzion për arsye se: vlerëson se administratori i Njesisë Administrative nr.2 pra, zoti Pullazi nuk është personi ligjërisht përgjegjës për

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.21.12.2021*

organizimin e aktiviteteve të ndryshme në bibliotekën në territorin e njësisë administrative të tij.

KAS vlerëson se është detyrë e Komisionerit që të përcaktojë qartë personat përgjegjës për shkeljen konkrete të ligjit, të konstatuar nga ankimi i bërë nga ai. Të riparaqesë në KAS, nqs e sheh të arësyeshme, një propozim konkret për sanksion administrativ për personat realisht përgjegjës.

Ndaj këtij vendimi mund të shtrohet ankim sipas ligjit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 115

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

